



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:282685  
Datë: 19.01.2024  
Numri i dokumentit: 05211861

**C-IV-14-0888**

*Parashtruesi i Ankesës*

**B K**, nga fshati L, Komuna e Suharekës

*kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (N.SH. “25 Maji” në Likuidim)**, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 19 janar 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Kërkesa për rishikim të Aktvendimeve të Autoritetit të Likuidimit aprovet pjesërisht si i bazuar.**
- II. VËRETOHET Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ045-0209 datë 31 janar 2014, me të cilin është refuzuar kërkesa e ankuesit për kompensimin 18 (tetëmbëdhjetë) pagave të papaguara.**
- III. SHFUQIZOHEN Vendimet e autoritetit të likuidimit PRZ045-0207 datë 20 janar 2014 dhe PRZ045-0208 me të cilin janë refuzuar kërkesat e ankuesit për kompensimin e 3 (tre) pagave të papaguara respektivisht dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.**
- IV. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, B K, që në emër të 3 (tre) pagave të papaguara ti paguhet shuma prej 1,230 Euro si dhe në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës ti paguhet shuma prej 2,460 Euro.**
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 18 shkurt 2014, ankuesi parashtrij kërkesë, të emërtuar padi, për rishqyrtimin e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit ( në tekstin e mëposhtëm AL ), si në vijim:

- a. PRZ045-0207 datë 20 janar 2014, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa për kompensimin e 3 (tre) pagave të pa-papaguara në shumë prej 1,230.00 (një dy tre zero) Euro,
- b. PRZ045-0208 datë 20 janar 2014, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë prej 2,460.00 (dy katër gjashtë zero) Euro, dhe
- c. PRZ045-0209 datë 31 janar 2014, me të cilin është refuzuar kërkesa për 18 (tetëmbëdhjetë) paga të papaguara, për periudhën prej datës 1 janar 2007 gjer 31 dhjetor 2008, në shumë prej 7,380.00 ( shtatë tre tetë zero) Euro,

(në tekstin e mëposhtëm Vendimet), kërkesa këto ndaj N.SH. “25 Maji” (në Likuidim).

Ankuesi pohon se edhe përkundër faktit se kërkesa e tij, sikurse edhe të gjithë punëtorëve tjerë, janë të mbështetura në prova AL duke mos respektuar ligjin në fuqi refuzon kërkesat e tij për kompensim të pagave.

Ankuesi tutje pohon se asnjëherë, nga ana e AL, nuk janë njoftuar respektivisht udhëzuar mbi afatin 3 (vjeçar) të paraqitjes së kërkesave e të cilit afat punëtorët është dashur që ti përmbahen.

Andaj nga gjitha arsyet propozon që kërkesat e tij, mbi pagat, të aprovohen.

Kërkesës për rishikim-ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e shkresës – njoftimin drejtuar ankuesit nga ana e AKP,
- Kopja e Njoftimit, datë 27 mars 2009, drejtuar ankuesit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke filluar nga data 27 mars 2009 ( në tekstin në vijim: NJOFTIMI),
- Kopjet e Vendimeve të AL, dhe
- Një kopje e Listës së pagave të papaguara për punëtorët e NSH, për periudhën janar, shkurt dhe mars të vitit 2009. Në këtë listë figuron emri e ankuesit sipas numrit rendor 2 ( në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE 1).

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 8 dhjetor 2022 parashtrij përgjigjen.

AKP, kundërshtoj kërkesë për rishikim-ankesën duke e konsideruar si të pabazuar pretendimet e ankuesit. AKP konsideroj se AL ka bërë një vlerësim të saktë si të rrethanave faktike e po ashtu se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë. Tutje, sipas AKP, ankuesi pretendimet e tij nuk i ka argumentuar, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Përfundimisht AKP konsideron se kërkesat kreditore të ankuesit, në tre rastet e kërkesave, janë pabazuar respektivisht konsiderohen të parashkruara, sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur me dispozitat ligjore të Ligjit mbi punën e bashkuar- LPB. Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa për rishikim-ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimet e AL të vërtetohen.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopjet e Vendimeve të AL, dhe
- Kopjen e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, ankuesi me 3 prill 2023 parashtrij përgjigjen.

Ankuesi kundërshtoj pretendimet e dhëna në përgjigjen e AKP dhe mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës.

Referuar urdhrorit të gjykatës, datë 25 maj 2023, ankuesi me 1 qershor 2023 me anë postës parashtron si në vijim:

- Letër konfirmimit datë 30 maj 2022, lëshuar nga ana e AKP, me të cilin vërtetohet se ankuesi ishte i punësuar pranë NSH nga data 19 qershor 1981 e gjer 31 maj 1995 dhe në vijim nga data 13 korrik 1999 e gjer 27 mars 2009 ( në tekstin në vijim LETËR KONFIRMIMI),
- Listën e pagave të papaguara të punëtorëve të NSH, për periudhën janar gjer dhjetor 2005 si dhe janar gjer qershor 2006 ( në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE 2),
- LISTËN E PAGAVE 1, dhe
- Kopjen e një faqe të librit amë të punëtorëve.

Gjykata gjatë procedurës së shqyrtimit dhe verifikimit, gjeti Listën e punëtorëve të kësaj NSH të cilët kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të hyrave të 20% nga privatizimi i NSH, listë kjo e publikuar nga ana e AKP. Sipas kësaj liste shihet se ankuesi, ishte i përfshirë dhe atë me përvojë pune pranë NSH me 23 viteve 3 muaj e 2 ditë (në tekstin në vazhdim: LISTA E PUNËTORËVE).

### **Arsyetimi ligjor**

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet si pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

### **Vendimi i AL PRZ045-0209 datë 31 janar 2014 -kërkesa për kompensimin e tetëmbëdhjetë (18) pagave**

Kërkesa për rishikim-ankesa, lidhur me Vendimin e AL të cekur si më lartë, konsiderohet si i pa-bazuar.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësit e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale respektivisht tetëmbëdhjetë pagave.

Në rastin konkret ankuesi kërkoj kompensimin e tetëmbëdhjetë pagave për periudhën nga 1 korrik 2007 e gjer 31 dhjetor 2008. LISTA E PAGAVE 1 dhe LISTA E PAGAVE 2 të parashtruara nga ankuesi nuk dëshmojnë obligimin e NSH ndaj ankuesit mbi 18 (tetëmbëdhjet) pagat. Për më tepër LISTA E PAGAVE 2 së cilës i referohet ankuesi i takon periudhës janar gjer

dhjetor 2005 si dhe janar gjer qershor 2006 ( gjithsejtë 18 muaj) e jo edhe për periudhën e kërkuar1 korrik 2007 e gjer me 31 dhjetor 2008.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person.

Nga dispozita e lartë cekur, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë.

Nga gjitha arsyet si më lartë cekura ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara si dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Për më tepër ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tetëmbëdhjetë (18) paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Ankuesi për më tepër nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Andaj u vendos si në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

*PRZ045-0207 datë 20 janar 2014 dhe PRZ045-0208 datë 20 janar 2014- kërkesat për kompensim për tre (3) paga të papaguara dhe dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës*

Kërkesa për rishikim-ankesa lidhur me Vendimet e AL të cekur si më lartë konsiderohet si i bazuar.

Në këtë rast gjykata konsideron se lidhur kompensimin, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim

nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar, duke u kufizuar në tri paga bruto por edhe përfshirë edhe kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë,
- b. Marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i Vendimit të AKP, dhe
- c. Ndonjë veprimi tjetër nga ana e Agjencisë, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj. dhe
- d. Kërkesat për paga të cilat nuk janë subjekt i trajtimit sipas kushteve të parapara sipas nenin 40 pika 1.6 paragrafi 1.6.1.

Në këtë rast gjykata gjeti ankuesi ka qenë punëtor i NSH gjer në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

NJOFTIMI, LISTA E PAGAVE 1, LETËR KONFIRMIMI lëshuar nga AKP dhe LISTA E PUNËTORËVE e publikuar nga AKP, argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor i NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, respektivisht se ankuesi ishte punëtor i regjistruar me të drejtë legjitime pranë NSH me rastin e përfitimit të një pjese të hyrave nga 20% nga privatizimi i NSH.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankueses, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankueses do ti mohohet e drejta në kompensimin e pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës respektivisht tre (3) pagave të papaguara. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet e vetme mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

LISTA E PAGAVE 1, listë kjo mbi pagat e mbetura borxh të punëtorëve të NSH e lëshuar dhe vërtetuar nga ana e organeve menaxhuese, sipas numrit rendor 2, dëshmon se paga bruto mujore e ankuesit ishte në shumë prej 410.00 (katër një zero) Euro e që i bie që për tre (3) paga të mbetura borxh në total të jetë prej 1,230.00 (një dy tre zero) Euro, aq sa edhe është kërkuar pranë AL.

Tutje gjykata gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi). Vitet e shërbimit – punës së ankuesit pranë NSH, gjykata i shumëzoi për pagën mujore prej 410.00 Euro e që në total i bie shuma e kërkuar pranë AL në lartësi prej 2,460.00 Euro (  $410 \times 6 = 2,460$  )

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesi në rastin konkret ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

#### Çështja e parashkrimit të kërkesave të ankuesit

NJOFTIMI, LETËR KONFIRMIMI dhe LISTA E PUNËTORËVE e publikuar nga AKP, argumentojnë faktin se ankuesi ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj.

Gjykata konsideron se ankuesi ka arritur ta dëshmoj, ashtu siç qëndron edhe në tekstin e saj, se ankuesi ka punuar pran NSH gjer me datën 27 mars 2009 andaj pavarësisht pohimeve të AKP, ankuesi ka dëshmuar se ishte punëtor i NSH gjer me datën e fillimit privatizimit, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e Agjencisë (neni 40 i Shtojcës së Ligjit për AKP).

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB ( gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

*“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.*

Së pari, duke u nisur mbi parimet e përgjithshme mbi parashkrimin të aplikuara dhe referuar sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), dhe duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore, në nenin 366 paragrafi 1 thuhet, citat:

*“Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi”*

Më tutje sipas nenit 370, të po të njëjtit ligj, thuhet:

*“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.*

Dispozitat e lartëcekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Sipas dispozitave të lartë cekura AKP me vet faktin e njoftimit me shkrim ndaj ankuesit për obligime nga marrëdhënia e punës konsiderohet se ka hequr dorë nga parashkrimi.

Tutje, rregullat për parashkrimin nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventual, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartëcekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (*lex specialis*).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në pikën 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar